



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
ODA E PËRMBARUESVE PRIVAT TË KOSOVËS
Komora Privatnih Izvršitelja – Chamber of Private Enforcement Agents



KODI

I ETIKËS SË PËRMBARUESVE PRIVATË

KODI I ETIKËS SË PËRMBARUESVE PRIVATË

Në mbështetje të nenit 382, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 3, e datës 31.01.2013), Kuvendi i Odës së Përmbartuesve Privatë të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11/12/2025, nxjerr:

KODIN E ETIKËS SË PËRMBARUESVE PRIVATË

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Qëllimi i këtij Kodi, duke u bazuar në interesin publik dhe sundimin e së drejtës, është vendosja e standardeve etike dhe profesionale të përmbartuesit me synimin e forcimit të profesionalizmit dhe përgjegjësisë së përmbartuesit gjatë kryerjes së autorizimeve të besuara publike ashtu si edhe përparimi dinjitetit dhe prestigjit të profesionit.
2. Ky kod zbatohet si ndaj punës së përmbartuesit, zëvendës përmbartuesit, zëvendësuesit të përmbartuesit ashtu edhe ndaj punës së personelit që punon në zyrën e përmbartuesit (të punësuarit, praktikantët, studentët).

Neni 2

Parimet e Kodit të Etikës

Kodi i Etikës së Përmbartuesve bazohet, por nuk kufizohet vetëm në, parimet e mëposhtme:

KODI I ETIKËS SË PËRMBARUESVE PRIVATË

1. **Publiciteti** – puna e përmbarduesit është publike dhe kryhet në pajtim me legjislacionin lidhur me publicitetin e procedurave gjyqësore, ndërsa përmbarduesi është i detyruar që gjykatës, ministrisë kompetente, si dhe organeve të Odës t'iu sigurojë të gjitha të dhënat për punën e vet në pajtim me ligjin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës;
2. **Ligjshmëria** – përmbarduesi gjatë kryerjes së autorizimeve publike të besuara e kryen shërbimin e vet me ndërgjegje, ndershëm dhe në mënyrë të paanshme në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin. Është detyrë e përmbarduesit që me zbatimin e Ligjit, të akteve nënligjore, të Statutit, të akteve të përgjithshme dhe të akteve tjera të detyrueshme në procedurën përmbardimore të harmonizojë procedurën dhe mënyrën e punës në tërë territorin e Republikës së Kosovës, në ç'mënyrë arrihet shkalla më e lartë e mundshme e sigurisë juridike ligjore, objektivitetit dhe besimi dhe evitimi i çdo lloje të konkurrencës jolojale dhe shkaktimi i dëmit në prestigjin e shërbimit përmbardimor dhe kolegëve të përmbarduesve. Përmbarduesi, është i detyruar që, për të gjitha veprimet e kundërligjshme për të cilat mëson në ushtrimin e punëve të përmbarduesit, ta njoftojë institucionin publik kompetent;
3. **Pavarësia** – përmbarduesi është i pavarur në kryerjen e autorizimeve dhe është i detyruar që të shpreh pavarësinë dhe të veprojë në pajtim me integritetin dhe autoritetin personal dhe profesional, duke patur parasysh interesat e palëve në procedurën e përmbardimit dhe të detyrave të përcaktuar me ligj , akte nënligjore dhe me

KODI I ETIKËS SË PËRMBARUESVE PRIVATË

akte të përgjithshme të Odës. Zëvendësi përmbartuesit është i pavarur në masën dhe sipas mënyrës së përcaktuar me ligjin për procedurën përmbartimore, si dhe me dispozitat e këtij Kodi në pjesën që i përket përmbartuesve,

4. **Ndërgjegjshmëria** – përmbartuesi është i detyruar që veprimtarinë e vet ta kryejë me ndërgjegje dhe detyrat e veta t'i kryejë në afatin e arsyeshëm duke respektuar personalitetin dhe të drejtat e pjesëmarrësve në procedurë dhe të personave të tretë;
5. **Dinjiteti** – përmbartuesi duhet të përmbahet nga sjellja e papërshtatshme, në çdo moment të veprjës në pajtim me standardet morale të profesionit të tij dhe të mbrojë prestigjin personal dhe profesional, si dhe prestigjin e profesionit;
6. **Paanshmëria** – përmbartuesi duhet të veprjës në mënyrën e njëjtë dhe të paanshme ndaj të gjithë personave në emër dhe dobi të të cilëve ndërmerr veprime, si dhe ndaj personave të tretë në barrën e të cilëve ndërmerr veprimet;
7. **Proporcionaliteti** – përmbartuesi, gjatë kryerjes së autorizimeve publike të besuara, duhet të ketë kujdes që të shkaktohen shpenzime vetëm në proporcion me nevojat e kredisë dhe shpenzimeve procedurale dhe që përmbartimi të kryhet vetëm në asete të lejueshme dhe të mundshme për përmbartim;

KODI I ETIKËS SË PËRMBARUESVE PRIVATË

8. **Profesionalizmi** – përmbarduesi është i obliguar që veprimtarinë e tij ta kryejë në mënyrë profesionale, për çka në mënyrë të vazhdueshme duhet të aftësohet profesionalisht në pajtim me planin dhe programin të cilin e përcakton Oda, si dhe që zëvendësve dhe zëvendësuesit e tij t'iu mundësojë aftësimin profesional kur ajo është e nevojshme me qëllim të kryerjes kualitative të punëve të besuara;
9. **Urgjencia dhe rendi i veprimit** – përmbarduesi nuk duhet të refuzojë që të veprojë në lëndën, për të cilën është kompetent, përveç në rastet e përjashtimit të paraparë me ligj. Përmbarduesi lëndët i merr në punë sipas renditjes së pranimit të tyre, përveç nëse rrethanat e veçanta kërkojnë që nga ajo renditje të hiqet dorë;
10. **Mbrojtja e dinjitetit të debitorit** – gjatë kryerjes së punës, përmbarduesi mbron dinjitetin e debitorit si dhe anëtarëve të familjes së debitorit;
11. **Papajtueshmëria** – Përmbarduesi duhet të përmbahet nga kryerja e punëve dhe të funksioneve të cilat janë të papajtueshme me punët e përmbardimit, siç janë kryerja e funksioneve publike, të funksioneve administrative apo kontrolluese në shoqëritë tregtare , kryerja e punëve të sigurimit, ushtrimi i profesionit të avokaturës dhe të profesioneve tjera gjyqësore, si dhe të punëve tjera të cilat janë të papajtueshme apo mund të dëmtojnë prestigjin e profesionit të përmbarduesit;
12. **Besueshmëria e të dhënave** – përmbarduesi është i obliguar që t'i ruajë si fshehtësi të punës të dhënat e

KODI I ETIKËS SË PËRMBARUESVE PRIVATË

besueshme deri të cilat vjen me rastin e ushtrimit të veprimtarisë së vet, përveç nëse shfrytëzimi i atyre të dhënave apo shpallja e tyre nuk lejohet me ligj. Gjithashtu, përmbaruesi është i detyruar që të kujdeset për sigurinë e dokumenteve deri te cilat vjen gjatë kryerjes së detyrave të veta dhe që ato dokumente të mos bëhen të qasshme për personat e paautorizuar pa dijen dhe lejen e personave për të cilët bëhet fjalë;

13. **Konflikti i interesit** – ekziston nëse përmbaruesi apo personi i lidhur me të (i afërm me përmbaruesin sipas gjakut në vijën e parë deri në cilëndo shkallë, ndërsa në vijën anësore deri në shkallën e katërt, kujdestari, aduptuesi apo i adoptoari, bashkëshorti apo jashtëmartesor apo i afërm sipas vjehrrit dhe vjehrrës deri në shkallën e dytë pa marrë parasysh se a ka pushuar martesë, apo personi i cili me përmbaruesin jeton në familje të përbashkët), ka interes privat i cili ndikon apo mund të ndikojë në kryerjen e punëve dhe detyrave të tij. Përmbaruesi nuk duhet të ndërmerr veprime në procedurë në të cilën ai apo ndonjë prej zëvendësve apo zëvendësuesi i tij ka interes pasuror apo interes tjetër, përveç në rastin e pagimit të kompensimit dhe të shpërblimit përmbaruesit në pajtim me ligjin dhe tarifën e paraparë. Konflikt i interesit do të konsiderohet edhe çdo rrethanë kur një dyshim arsyeshëm ngritët përkitazi nëse interesi personal i përmbaruesit mund ta ndikojë paanshmërinë e tij apo të saj gjatë ushtrimit të veprimtarisë përmbarimore;

KODI I ETIKËS SË PËRMBARUESVE PRIVATË

14. **Shpenzimet e procedurës** – përmbauesi nuk duhet të kontrakttojë apo paguajë shuma tjera të kompensimit dhe të shpërblimit nga ato që janë paraparë në tarifën e vlefshme, dhe as shuma të cilat janë më të mëdha se ato që me atë tarifë janë paraparë. Përmbauesi është i detyruar që në mënyrë të rregullt të përpilojë regjistrin e të gjitha kompensimeve dhe të shpërblimeve që nevojitet t'i paguajë dhe për atë me kohë t'i njoftojë pjesëmarrësit në procedurë.

Neni 3

Veprimet ose deklaratimet në kundërshtim me Kodin

Veprimet ose deklaratimet e përmbauesit si më poshtë dhe veprime tjera kundër nderit dhe prestigjit të përmbaimit konsiderohen veprime të palejueshme dhe shkelje të Kodit. Këto veprime ose deklarime përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

1. thirrja në lidhje të mira;
2. lënia personave të tretë të autorizimeve apo të materialit reklamues;
3. premtimi apo dhënia e provizionit apo shpërblimit personave tjerë për përfitimin e palëve;
4. përcëmime të përmbauesve tjerë;
5. paraqitja në cilëndo formë të kritikës së punës apo të sjelljes së kolegëve para palëve përveç vërejtjeve të nevojshme për ndërmarrjen e ligjshme të veprimeve zyrtare;

KODI I ETIKËS SË PËRMBARUESVE PRIVATË

6. pagimi i kompensimit për veprimet zyrtare në shumën më të lartë apo më të ulët nga tarifa e paraparë;
7. sponsorizimi apo dhurimi i disa ngjarjeve të aktiviteteve apo të individëve me qëllim të reklamimit të drejtpërdrejtë apo indirekt apo të promovimit të ndonjë përmbarduesi;
8. paraqitjet publike me qëllim të reklamimit indirekt apo të drejtpërdrejtë;
9. marrja pjesë si blerës në ndonjë shitje publike të sendeve të luajtshme apo të paluajtshmërive sipas publikimit të konkluzionit për shitje;
10. përmbarduesi për të cilin në mjetet e informimit publik shkruhet apo flitet ashtu që i shkaktohet dëmi në prestigjin e atij përmbarduesi është i detyruar që menjëherë të kërkojë nga Oda që Oda në mënyrë të përshtatshme dhe pa shtyrje të distancohet nga raportimet e tilla. Oda është e detyruar që pa shtyrje të kërkojë korrigjimin e informacioneve të pavërteta dhe jo të plota në pajtim me dispozitat e veçanta;
11. pranimi nga ndonjë person, qoftë ai palë ose jo palë e më aktivitetit të tij zyrtar, ndonjë përfitim të papërshtatshëm i cili mund të ndikojë veprimet e tij në atë aktivitet zyrtar përmbarduesi i cili do të paraqiste dyshime të arsyeshme për pavarësinë dhe paanshmërinë e tij. Këto përfitime të cilat nuk mund të pranohen, përfshijnë por nuk kufizohen në dhurata, në para apo huadhënie, donacione, shërbime, angazhime në ndonjë aktivitet biznesor potencial të përmbarduesit, premtime për punë, dhënie të

KODI I ETIKËS SË PËRMBARUESVE PRIVATË

këshillave apo informacion apo premtim për ndonjë favor zyrtar, qoftë nëse ai shërbim i jepet përmbauesit personalisht, ndonjë anëtar i familjes së tij apo ndonjë personi tjetër.

Neni 4

Fshehtësia zyrtare

1. Përmbauesi është i detyruar që të ruajë fshehtësinë zyrtare në pajtim me Ligjin.
2. Përmbauesi duhet të sigurojë ruajtjen e fshehtësisë me organizimin e punës në zyrën e tij, e në veçanti lidhur me korrespondencën të cilën e mban në mjetet e informimit publik dhe në pikëpamje të organizimit të arkivës së përmbaimit.
3. Përmbauesi nuk duhet të shprehë kureshtjen në pikëpamje të fakteve të cilat nuk i përkasin dhe nuk duhet në mënyrë jo të përshtatshme të komentojë sjelljet e dikujt.
4. Përmbauesi, zëvendësit dhe zëvendësuesi përmbauesit si dhe të gjithë të punësuarit në zyrën e përmbauesit njësoj përgjigjen për detyrimin e ruajtjes së fshehtësisë.

Neni 5

Marrëdhëniet me palët dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë

Përmbauesi duhet që në raport me palët dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë:

KODI I ETIKËS SË PËRMBARUESVE PRIVATË

1. të sillet me dashamirësi dhe respekt;
2. të posedojë kartelën zyrtare të cilën e lëshon Ministria e Drejtësisë dhe të cilën është i detyruar që ta tregojë me rastin e veprimit;
3. ndalohet ushtrimi i ndikimit në sjelljen e përmbarduesit me klientët e tij apo të ndikojë në klientin që lëndën e tij ta bartë në përmbarduesin tjetër;
4. që në mënyrë të plotë dhe me kohë ta njoftojë klientin me të gjitha informacionet të cilat janë në lidhje me veprimin sipas kërkesës së tij, ta informojë për veprimet të cilat i ka ndërmarrë dhe të atyre që synon t'i ndërmarrë;
5. palëve në procedurën e përmbardimit t'u japë një dokument i cili përmban të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Neni 6

Marrëdhëniet me Odën, Përmbarduesit, dhe Personelin e Përmbarduesve

1. Përmbarduesi është i detyruar që plotësisht dhe me kohë t'i plotësojë të gjitha obligimet ndaj Odës, të respektojë, ruajë dhe mbrojë prestigjin e Odës dhe të kolegëve përmbardues dhe të kontribuojë për punën e përbashkët sa më të suksesshme.
2. Përmbarduesi është i detyruar që ta njoftojë Odën për problemet me rëndësi të përgjithshme për shërbimin e përmbardimit, në veçanti për marrëdhëniet me organet publike pa ndërmarrjen e iniciativave personale deri në vendimin e organeve të Odës.

KODI I ETIKËS SË PËRMBARUESVE PRIVATË

3. Përmbarduesi është i detyruar që në mënyrë të rregullt të marrë pjesë në mbledhjet e organeve të Odës, në veçanti në Kuvendet e Odës dhe me pjesëmarrjen e vet aktive të kontribuojë në punën e tyre sa më të suksesshme. Zgjedhja në cilindo organ të Odës për çdo përmbardues është nder, andaj përmbarduesi nuk mund ta shmangë përveç në rastin kur gjendja shëndetësore nuk e lejon punën në ato organe apo nëse është zgjedhur apo emëruar në disa funksione në organin e Odës dhe vetë çmon se në mënyrë kualitative nuk mund t'i kryejë.
4. Përmbarduesi duhet të përpiqet që të zhvillohen dhe kultivohen marrëdhëniet kolegjiale në mes të përmbarduesve, marrëdhëniet e punës, bashkëpunimit, besimit dhe të solidaritetit.
5. Përmbarduesi duhet që ndaj përmbarduesve tjerë si dhe ndaj personelit të zyrës së përmbarduesve tjerë të silltet në mënyrë kolegjiale, me respekt dhe të mos komentojë për profesionalizmin e tyre.
6. Përmbarduesi është i detyruar që t'i shmanget situatatave apo veprimet që mund të krijojnë konkurrencë të padrejtë dhe duhet ta njoftojë Odën menjëherë sapo të vihet në dijeni për ndonjë situatë apo veprim që mund të konsiderohet konkurrencë e padrejtë.

Neni 7

Marrëdhëniet e Përmbarduesit me zëvendësit dhe zëvendësuesit e përmbarduesit

KODI I ETIKËS SË PËRMBARUESVE PRIVATË

1. Përmbauesi duhet t'i kushtojë kujdes të veçantë punës me zëvendësit dhe zëvendësuesit e tij. Përmbauesi duhet të kujdeset për aftësimin profesional më të suksesshëm dhe të ngritjes së zëvendësve dhe zëvendësuesit.
2. Përmbauesi është i detyruar që menjëherë pas pranimit të zëvendësve dhe zëvendësuesit t'iu shpjegojë dispozitat e këtij Kodi, të Statutit të Odës, dhe të akteve tjera të përgjithshme, si dhe bazat për mënyrën e sjelljes dhe të programit për aftësimin praktik.
3. Përmbauesi është i detyruar që ndihmësve dhe zëvendësuesit t'ua bëjë me dije për sjelljen e tyre ndaj përmbauesve, qytetarëve dhe organeve të Odës.
4. Përmbauesi me vëmendje të veçantë duhet t'iu udhëzojë zëvendësit dhe zëvendësuesin lidhur me parimet e etikës përmbauese, pa të cilat dituritë profesionale dhe dituritë e fituara praktike nuk do të kishin vlera përkatëse. Zëvendësit dhe zëvendësuesi për punën e tyre duhet të shpërblehen sipas Ligjit.
5. Marrëdhënia në mes të përmbauesit dhe zëvendësve dhe zëvendësuesit të tij, nuk duhet në çfarëdo forme të paraqesë keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe të besimit.
6. Zëvendësit dhe zëvendësuesi i përmbauesit janë të detyruar që të ruajnë sekretin profesional të cilën e kanë mësuar gjatë kohës së aftësimit të tyre profesional, kur u pushon marrëdhënia e punës në zyrën përmbauese.

KODI I ETIKËS SË PËRMBARUESVE PRIVATË

Neni 8

Sjellja ndaj të punësuarve

1. Përmbauesi është i obliguar që të punësuarve në zyrën e përmbauesit t'u mundësojë aftësimin dhe nxitje të plotë në fitimin e gjithëmbarshtëm dhe thelbësor të praktikës dhe diturisë së nevojshme duke u kujdesur për përgatitjen profesionale të punësuarve.
2. Përmbauesi është i obliguar që me kujdes në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore t'ua ndajë punët të punësuarve, të mbikëqyrë punën e tyre, të kujdeset për statusin e tyre, e në veçanti në kryerjen e punëve dhe të sjelljes me palët.
3. Përmbauesi të punësuarit në zyrën e përmbauesit duhet t'i udhëzojë dhe njoftojë me parimet e Etikës së përmbauesve dhe t'i obligojë për sjellje të përshtatshme në jetën e përditshme.
4. Përmbauesi të punësuarve duhet t'u ofrojë kushte adekuate për punë dhe aftësim profesional dhe statusin ligjor të punësuarve në pajtim me Ligjin për punë.
5. Përmbauesi është i obliguar që t'i plotësojë të gjitha detyrimet materiale ndaj të punësuarve në pajtim me dispozitat pozitive.
6. Përmbauesi është i obliguar që të punësuarve t'ua bëjë me dije për obligimin për veshjen e përshtatshme gjatë kohës së punës në zyrën e përmbauesit, e në veçanti për sjellje të kulturuar dhe të dëshirueshme me palët.

Neni 9

KODI I ETIKËS SË PËRMBARUESVE PRIVATË

Marrëdhëniet me Publikun

1. Përmbarduesi, Zëvendës-Përmbarduesi, Zëvendësues i Përmbarduesit, dhe personeli i zyrës përmbardimore duhet të veprojnë në publik në pajtim me standardet dhe praktikat e pranura të profesionit.
2. Personat si më lart duhet të përmbahen nga veprimi ose deklarimi në mënyra shqetësuese, turpëruese, ose fyese ndaj publikut në përgjithësi ose ndonjë individ në veçanti, si dhe duhet të përmbahen nga deklaratimet e papërshtatshme ose të pasakta.
3. Personat si në dispozitën 1 të këtij neni duhet që, gjatë punës zyrtare, të vishen në mënyrë të përshtatshme me funksionin e tyre dhe të mos bartin veshje ose gjësende të papërshtatshme me profesionin.
4. Personat si në dispozitën 1 të këtij neni nuk mund që në emër të Odës ose lidhur me punën e Odës të paraqesin deklarata ose intervista në medie, përveç nëse autorizohen nga organet e Odës.

Neni 10

Aftësimi i vazhdueshëm profesional

1. Përmbarduesi është i detyruar që në mënyrë të përhershme t'i ngritë njohuritë e tij/saj profesionale dhe të përgjithshme, si dhe që njohuritë e veta pa interes t'ua bartë në zëvendësuesin dhe zëvendësit e përmbarduesit.
2. Është e palejueshme që përmbarduesi aktivitetet e veta t'i shfrytëzojë në kundërshtim me parimet e këtij kodi,

KODI I ETIKËS SË PËRMBARUESVE PRIVATË

ndërsa me qëllim të të vënurit në pah të profesionit të tij përmbardues, apo në cilëndo mënyrë me synim të reklamimit.

3. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni, veprimet e mëposhtme nuk konsiderohen reklamim i ndaluar:
 - Mbajtja e një faqeje interneti profesionale e cila përmban vetëm informacione themelore për zyrën, si emri i përmbarduesit, adresa, informatat e kontaktit, orari i punës, legjislacionin bazik si dhe kompetenca territoriale;
 - Vendosja e një tabele të zyrës në përputhje me standardet e miratuara nga Ministria dhe Oda;
 - Pjesëmarrja në aktivitete të zhvillimit profesional, seminare, konferenca apo ligjërata akademike;
 - Publikimi i artikujve shkencorë dhe profesionalë në fushën e së drejtës."
4. Përmbarduesi është i detyruar që, gjithmonë dhe në çdo kohë në ushtrimin e profesionit të përmbardimit dhe në jetën e tij private, të manifestojë shkallë të prestigjit personal dhe moral.
5. Mosaftësimi i vazhdueshëm profesional është shkelje e dispozitave të këtij Kodi dhe dispozitave ligjore.

Neni 11

Transparenca Financiare dhe Llogaridhënia

1. Përmbarduesi është i detyruar që në afarizmin financiar të veprojë me transparencë, ndërgjegje dhe kujdes dhe që

KODI I ETIKËS SË PËRMBARUESVE PRIVATË

bartjen e mjeteve në llogaritë përkatëse ta kryejë në pajtim me ligjin dhe me aktet e tjera të përgjithshme.

2. Përmbartuesi është i detyruar që të ofrojë të dhëna, informata dhe raporte financiare në pajtim me kërkesat ligjore ose kërkesat e Odës.

Neni 12

Procedura e Trajtit të Ankesave dhe Shkeljeve të Kodit

1. Çdo palë, person i interesuar, apo përmbartues tjetër ka të drejtë të paraqesë ankesë (kërkesë) me shkrim për shkelje të dyshuar të këtij Kodi. Kjo përfshin edhe mosmarrëveshjet reciproke ndërmjet përmbartuesve.
2. Ankesa i paraqitet Komisionit të Etikës Profesionale (në tekstin e mëtejme: Komisioni) përmes arkivit të Odës. Ankesa duhet të paraqitet brenda 30 ditësh nga dita e të mësuarit për shkeljen.
3. Në rastin e ankesave që burojnë nga mosmarrëveshjet reciproke ndërmjet përmbartuesve , Komisioni i Etikës Profesionale fillimisht do të ofrojë shërbimin e ndërmjetësimit siç parashihet në nenin 13 nënparagrafi 1.5 të këtij Kodi. Vetëm në rast të dështimit të ndërmjetësimit ose nëse Komisioni vlerëson se ndërmjetësimit është i papërshtatshëm për rastin, ai vazhdon me procedurën e ankesës të përshkruar në këtë nen.

KODI I ETIKËS SË PËRMBARUESVE PRIVATË

4. Komisioni e njofton përmbaruesin ndaj të cilit është bërë ankesa, duke i kërkuar një deklaratë me shkrim brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit. Komisioni mund të ftojë palët në ballafaqim me gojë.
5. Nëse përmbaruesi nuk ofron deklaratë në afatin e caktuar, Komisioni nxjerr mendim bazuar në të dhënat me të cilat disponon.
6. Komisioni, jo më vonë se 30 ditë nga pranimi i ankesës, nxjerr një Mendim me shkrim ku vërteton nëse ka pasur apo jo shkelje të Kodit. Nëse Komisioni konstaton se ka pasur shkelje, Mendimi i tij duhet të përfshijë edhe një propozim të arsyetuar për masën që duhet ndërmarrë.
7. Mendimi i Komisionit, së bashku me propozimin, i dërgohet Kryetarit të Odës.
8. Bazuar në propozimin e Komisionit, Kryetari i Odës është i autorizuar të shqiptojë masën e paralajmërimit gojor ose paralajmërimit me shkrim ndaj përmbaruesit. Paralajmërimi me shkrim vendoset në dosjen personale të përmbaruesit.
9. Në rastet kur Komisioni vlerëson se bëhet fjalë për shkelje të rëndë të detyrës zyrtare, ose në rastin e përsëritjes së shkeljeve të Kodit përkundër masave të shqiptuara, Komisioni i dërgon Mendimin e tij të arsyetuar Kryetarit të Odës.
10. Në rastet e përcaktuara në këtë nen që paraqesin shkelje të rënda, sipas vlerësimit të tij/saj, Kryetari i Odës, në pajtim me autorizimet e tij/saj ligjore dhe statutore, bën

KODI I ETIKËS SË PËRMBARUESVE PRIVATË

inicimin e procedurës disiplinore pranë Komisionit Disiplinor kompetent.

Neni 13

Komisioni i Etikës Profesionale

Kompetencat e Komisionit të Etikës Profesionale, përveç dispozitave tjera, janë edhe këto:

1. Kërkimi, pranimi, klasifikimi, analizimi, dhe përmbledhja e informatave lidhur me punën dhe sjelljen e përmbarduesve dhe personave si në nenin 1.2, me qëllim të përmirësimit të Kodit të Etikës;
2. Përmbledhja e praktikave profesionale aktuale përmes intervistave dhe pyetësorëve;
3. Përcjellja e zbatimit dhe interpretimi i Kodit të Etikës;
4. Ofrimi i ndihmës për trajnime eventuale lidhur me etikën profesionale;
5. Ofrimi i shërbimit të ndërmjetësimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet dy ose më shumë përmbarduesve;
6. Sugjerimi i ndryshimeve për plotësimin e Kodit të Etikës bazuar në praktikën e gjetura tek përmbarduesit, ndryshimet legjislative dhe organizative të profesionit, si dhe standardet ndërkombëtare;
7. Përgatitja e raportit vjetor për veprimtarinë e tij dhe dërgimi i raportit tek Kryetari i Odës.

KODI I ETIKËS SË PËRMBARUESVE PRIVATË

Neni 14

Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

1. Dispozitat e këtij Kodi duhet të interpretohen në pajtim me LPP-në, aktet e tjera të përgjithshme të Ministrisë së Drejtësisë, Odës, Gjykatës Supreme, si dhe standardet dhe praktikrat më të mira ndërkombëtare të përmbartimit.
2. Pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi, shfuqizohet Kodi i Përkohshëm MD-NR.07/2014 i Etikës së Përmbartuesve Privatë.
3. Ky Kod u miratua nga Kuvendi i Odës së Përmbartuesve me datë 11.12.2025 dhe hyn në fuqi pas dhënies së pelqimit nga Ministri i Drejtësisë në përputhje me nenin 383 par. 2 të Ligjit 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore.

Kryetari i Odës

Mehdi S. Reshani



**Shkarko versionin elektronik të
KODIT TË ETIKËS**